



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTJEVE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1243 prot.

Tiranë, më 23.09.2024

Lënda: Dërgim Informacioni

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Blv. "Bajram Curri", Tiranë

Ju informojmë se, në Drejtorinë e Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Tiranë, në zbatim të VKB Nr. 86, datë 09.09.2024, "Për disa ndryshime në VKB nr. 50, datë 03.05.2023, i ndryshuar "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të institucioneve të varësisë", Urdhrit Nr. 1029, datë 28.03.2024, "Për miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë"; "Kodi i sjelljes dhe etikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve" Nr. 1349/5 prot, datë 12.12.2023; Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. 2234, datë 08.08.2024 "Për miratimin e strukturës organike të Drejtorisë së Përgjithshme të Çerdheve dhe Kopshteve, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës", shpallen **20 (njëzet)** vende të lira pune për **edukatore në çerdhe**, (Kategoria/Klasa IV-b, grupi 1/2/3/4).

Dokumentacioni i kërkuar në dosjen personale, në momentin që aplikanti shpallet fitues:

1. CV
2. Vërtetim banimi
3. Çertifikatë personale dhe familjare
4. Dëftesë/ Diplomë + listë notash (kopje të noterizuara)
5. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)
6. Librezë pune origjinale
7. Raport mjeko – ligjor
8. Dëshmi penaliteti (deri në momentin e paisjes me dëshmi penaliteti, fotokopje të kuponit të aplikimit në postë)
9. 2 fotografi

Disa nga detyrat që duhet të kryejë një edukatore në çerdhe janë:

1. Punon nën drejtimin e Përgjegjëses së Çerdhes dhe udhëzimeve të mjekut, psikologut, dhe punonjësit social.
2. Monitoron gjendjen shëndetësore të fëmijëve gjatë gjithë qëndrimit në çerdhe, njofton në kohë përgjegjësen për problemet shëndetësore të konstatuara dhe i pasqyron ato në filtrin ditor.
3. Kujdeset çdo ditë për fëmijët, në drejtim të higjenës personale, të ushqyerit, të ndërruarit e veshmbathjeve, edukimit shoqëror. Në bashkëpunim me specialistët e sektorit psiko-social ndihmon në stimulimin e fushave të zhvillimit të fëmijës si psh: zhvillimi fizik, psiko-emocional, si dhe përdor metoda të efektshme për inkurajimin e zhvillimit fizik, social, emocional, gjuhësor dhe edukativ të fëmijëve 0-3 vjeç.
4. Njeh dhe zbaton programin e edukimit të fëmijëve sipas formatit të përcaktuar.
5. Në bashkëpunim me psikologun/punonjës social ndjek planin individual të ecurisë dhe zhvillimit të fëmijëve me nevoja të veçanta.
6. I raporton me shkrim turnit pasardhës, lidhur me problematikat e konstatuara tek fëmijët.
7. Mban përgjegjësi për rregullin dhe higjenën brenda grupit.
8. Merr pjesë në pastrimin e përgjithshëm të çerdhes në rast të lyrjes, dezinfektimit apo pastrimit gjeneral të ambienteve të brendshme dhe të jashtme.
9. Krijon një mjedis të përshtatshëm duke përdorur mjete didaktike/vizatime/figura referuese/punime dore etj, për zhvillimin e programit të edukimit për fëmijët 6 muaj -3 vjeç.
10. Informon rregullisht prindërit për ecurinë e fëmijës gjatë qëndrimit në çerdhe.
11. Zbaton Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.
12. Duhet të jetë e pajisur me certifikatën e vlefshme për dhënien e ndihmës së parë nga subjekte të liçensuara kombëtare/ndërkombëtare.

Për sa më sipër sqarojmë se:

Për pozicionin e punës si Edukatore në çerdhe, duhen plotësuar kriteret e mëposhtme:

-Të ketë mbaruar arsimin e lartë Mësuesi/Shkenca Sociale/Shkenca Mjekësore.(Bachelor)

-Të ketë eksperiencë pune në lidhje me fëmijërinë e hershme (grupmosha 0-3 vjeç).

Afati për dërgimin e CV- ve në email: femijet@tirana.al është deri më datë 02.10.2024.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.

DREJTORI PËRGJITHSHË

